Pyetje-përgjigje

Hoxhë Lulzim Perçuku – Marrë nga derset live - Transkriptim

1. A ka mëkat një femër e cila nuk është e mbuluar, por fal namazin dhe agjëron?

Ajo ka mëkatin e mosvënies së mbulesës, e kjo pa dyshim është prej mëkateve të mëdha, sepse Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka treguar se Allahu ia ka shfaqur atij dy grupe të njerëzve që do të dalin para Kiametit dhe që e kanë dënimin më të ashpër tek Allahu, njëri grup janë disa persona që mbajnë disa kamxhikë si bishtat e lopës me të cilët i godasin (rrahin) njerëzit dhe një grup tjetër janë ato femra që janë të mbuluara dhe njëkohësisht të zbuluara- kjo ka shumë kuptime siç kanë përmendur dijetarët, janë të mbuluara mirëpo kanë rroba të tejdukshme, apo i kanë aq të ngushta që ia përshkuajnë trupin- dhe i kanë kokat sikurse gungat e devesë, qëllimi është se frizurën dhe flokët i mbajnë në atë formë. Çdo mashkull që sheh një femër të tillë dhe fitnoset/sprovohet me pamjen e saj, asaj i shkon një pjesë e mëkatit. Ajo ka gjynah të madh nëse nuk mbulohet, mirëpo namazi dhe agjërimi in shaa Allah i pranohet, edhe pse nuk është e mbuluar në jetën e përditshme.

2. Nëna thotë: "Nuk mund të falem sepse nuk mund ta kontrolloj urinën". Si e këshilloni?

Kjo është vesvese, cytje e shejtanit që ia bën asaj. Shejtani përmes kësaj gjëje e ka gjetur një mënyrë që ta pengojë për faljen e namazit. E pa dyshim se shejtani është armik i njeriut dhe mundohet ta ndalojë atë nga të vepruarit e veprave të mira. E vepra më madhore që e kryen njeriu është namazi; ai është shtyllë e Islamit. Njeriu nuk duhet ta lejojë veten të bie në këtë cytje. Allahu thotë: **"Allahu nuk e ngarkon njeriun përtej mundësive".** Po ashtu thotë: **"Keni frikë Allahun aq sa keni mundësi".** Andaj, ajo le të falet sipas mundësive, pa e braktisur namazin. Përderisa njeriu ka mendje të shëndoshë, duhet të kryejë namazin. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë të falemi në këmbë, nëse nuk mundemi atëherë falemi ulur. A i lejohet dikujt të thotë se meqë s'po mundem të falem në këmbë, atëherë nuk falem fare?! Jo, Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ta ka lehtësuar këtë. Nëse nuk mundesh as ulur, atëherë falesh shtrirë. E gjithë kjo është lehtësim prej Allahut të Madhëruar. Islamin e ka bërë lehtësim për njerëzit. Nëse njeriu nuk mund ta kryejë një adhurim ashtu siç ka urdhëruar Allahu, atëherë e kryen sipas mundësive, dhe tek Allahu ky adhurim konsiderohet i plotë. Kjo është prej mirësive të fesë islame. Shembull: nëse njeriu nuk mund të falet në këmbë, por falet ulur, namazin e ka të plotë. Nëse kjo nënë nuk ka mundësi ta kontrollojë urinën, atëherë tek Allahu namazin e ka të plotë. Mirëpo, se si vepron personi në këtë rast, dijetarët thonë:

-duhet të presë hyrjen e kohës së namazit, pastaj e vendos një pecetë te vendi dhe merr abdes; me atë

abdes e fal namazin e atij vakti (farz, sunet, apo dhe nafile),
-kur hyn koha e namazit tjetër, e largon atë pecetë, e pastron vendin, e vendos pecetën e re, merr abdes dhe e fal namazin e atij vakti.
Kështu vepron secili që ka probleme shëndetësore të tilla. Por, dikush tjetër mund të ketë problem me gazra. As të tillit nuk i thuhet "mos u fal", sepse namazi është shtylla e fesë, nuk braktiset.

3. A duhet të thuhen lutjet kuranore në teshehudin e parë, apo veç në të fundit (para selamit)?

Në këtë pikë ka mospajtime mes dijetarëve. Shejkh Albani ka mendimin se edhe në teshehudin e parë lejohet thënia e duave dhe për këtë sjell disa argumente. Dijetarët e tjerë kanë thënë se nuk thuhen lutjet në teshehudin e parë. Pastaj dijetarët kanë mospajtime se në teshehudin e parë a thuhet veç etehijati apo edhe salavatet. Shumë prej dijetarëve thonë se thuhet veç etehijati, pa salavatet, dhe sjellin një hadith në të cilin tregohet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka qëndruar në teshehud shumë pak, si një njeri që është i ulur në një gurë të nxehtë. E nga kjo kuptohet se ai nuk ka thënë më gjatë sesa etehijatin (së bashku me shehadetin), ngase ai që qëndron në një gurë të nxehtë qohet shpejt. E nuk thuhet edhe për atë njeri që i thotë edhe salavatet se mund të qëndrojë në një gurë të nxehtë derisa t'i kryen ato. Dijetarët e tjerë dhe shejkh Albani, të cilët e kanë mendimin se thuhen salavatet në

uljen e parë, sjellin argument Fjalën e Allahut: **"Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O besimtarë, edhe ju çoni salavate dhe selam!"** Ahzab 56. Sahabët pyetën: *"Ne e kuptuam selamin si është..."*, është fjala për etehijatin në namaz (ngase në të ne themi esselamu alejke ejuhen nebiju ue rahmetullahi ue berekatuhu), *"...mirëpo, si janë salavatet*?" Atëherë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ua mësoi salavatet ibrahimije (që i themi pas etehijatit). Andaj, nga kjo kuptojmë se ky ajet kuranor ka zbritur për teshehudin. Nëse në teshehudin e parë çon selame, atëherë duhet të dërgosh edhe salavate. Kështu po kuptohet prej këtij ajeti, Allahu e di më së miri se cili është mendimi më i saktë. Ndërsa sa i përket lutjeve kuranore, siç ka ardhur pyetja, nuk ka argument se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë lutje kuranore, qoftë në teshehudin e parë apo të dytë. Ai i ka thënë disa lutje, të cilat janë të transmetuara, shembull: kërkimi i mbrojtjes prej katër gjërave (dënimit të xhehenemit, dënimit të varrit, sprovës së jetës dhe vdekjes dhe sprovës së Dexhallit), dhe lutje të tjera. Atë që e thamë më lartë është për lutjet që janë të transmetuara nga Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem. Nëse personi i thotë ato në teshehudin e parë lejohet, mirëpo më mirë është të mos i thotë.

4. A lejohet të marr abdes duke i larë gjymtyrët nga një herë, apo nga dy herë, apo nga tri herë?

Po, të gjitha këto forma janë të lejuara. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka marrë abdes duke i larë

pjesët e abdesit nga një herë, nga dy herë e nga tri herë. Në një tjetër transmetim thotë se ai salAllahu alejhi ue selem ka përzier mes këtyre, duke i larë disa nga një, disa nga dy e disa nga tri herë. Është pyetur shejkh Abbadi (Allahu e ruajttë) se nëse personi merr abdes tërë jetën duke i larë pjesët e abdesit vetëm nga një herë, a e kundërshton sunetin me këtë, e ai është përgjigjur se jo, sepse kjo është transmetuar nga Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem. Nëse njeriu merr abdes duke i larë pjesët e abdesit veç nga një herë, nuk ka të keqe. Nëse merr abdes duke përzier mes numrit të larjeve, disa një herë, disa dy herë e disa tri herë, nuk ka të keqe.

5. Nëse i zbathi mestet, a kam abdes?

Nëse njeriu i ka mbathur çorapet duke qenë me abdes e pastaj e ka prishur abdesin, i lejohet të marrë mest mbi to brenda 24 orëve nëse është vendas, dhe tri ditë e tri netë nëse është udhëtar, duke mos pasur nevojë t'i zbathë ato e t'i lajë këmbët sa herë që merr abdes. Mesti llogaritet prej kohës kur u ke dhënë mest herën e parë duke qenë me abdes, e jo kur i ke mbathur çorapet apo kur ke marrë abdes. Shembull: kur je zgjuar për namazin e sabahut ke marrë abdes dhe i ke veshur çorapet, ke qëndruar pa i zbathur ato deri në drekë dhe në kohën e drekës u jep mest. Koha që ka nisur mesti për ty në këtë rast pra është koha e drekës, dhe prej tash deri në kohën e ardhshme të drekës të lejohet t'u japësh mest. E nëse i zbath çorapet duke pasur mest, se a ke abdes apo jo, këtu ka mospajtime mes dijetarëve. Disa thonë se edhe pse zbathen mestet, abdesi ende është i vlefshëm; në

këtë rast prishet veç mesti. E disa të tjerë kanë mendimin se prishet edhe abdesi.

6. Nëse një mysliman tallet me xhilbabin duke i thënë çarçaf, sofrabez, si fjalë nënçmuese, a bën kufër me këtë dhe a i asgjësohen veprat?

Nëse ndokush nuk përqeshet me fenë, por me një pjesë të fesë, duke pasur mendim se ajo gjë nuk është prej fesë, nuk bën kufër. Ka raste kur të tjerët tallen me ata që kanë mjekra duke menduar se janë sekt dhe se kanë sjell diçka të re në fe, sepse sipas tyre mjekra nuk është prej fesë, ky është injorant e nuk e di, ndoshta dhe e fal namazin dhe nuk e di se vetë Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem dhe shokët e tij kanë pasur mjekra dhe se ai ka urdhëruar të lëshohet mjekra; apo rasti i xhilbabit që thonë se është traditë arabe e nuk është prej fesë islame, andaj dhe përqeshen, atëherë në të tilla raste nuk themi se ata janë përqeshur me fe dhe se kanë bërë kufër. Të tillëve duhet t'u sqarohet e vërteta me argumente (t'u ngritet argumenti). E kur t'u bëhet e qartë e vërteta (nëse u bëhet e qartë), atëherë mund të ndryshojë vendimi për ta se a bëjnë kufër apo jo. Ky vendim nuk na takon neve. Kur njeriu bën kufër e kur jo, vendosin gjykatësit myslimanë, apo dijetarët e mëdhenj.

7. U betova se s'do ta dërgoj filanin në një vend me makinë, por pastaj e dërgova duke e harruar betimin, me çfarë obligohem?

Nëse personi është betuar në Allahun, me zemër, me vetëdije të plotë, duke thënë: "Pasha Allahun, nuk do ta dërgoj filanin në atë vend" dhe pastaj e ka dërguar, atëherë ai e ka thyer betimin. Në këtë raste duhet bërë kefaret (shpagim):
-lirohet një rob (në kohën tonë kjo mundësi nuk është),
-nëse kjo nuk është e mundur, atëherë i ushqen ose i vesh 10 të varfër (ushqimi i tyre bëhet me ushqim mesatar, me atë që i ushqen familjen, pa e tepruar shumë, por as duke dhënë ushqim më të ligë sesa ushqimi që e ha me familjen),
-e nëse as për këtë nuk ka mundësi, atëherë i agjëron tri ditë.
E nëse personi është betuar pa zemër, pa vetëdije, por thjeshtë si shprehje e gjuhës siç e kanë shprehi të thonë: "uAllahi uAllahi", atëherë nuk ka obligim asgjë.

8. A lejohet të shkoj te një mjek i cili i mbyt hormonet e vajzave (për të mos lindur vajzë), meqë i kam dy dhe pas kësaj shpresohet lindja e një djali?

Kjo nuk lejohet ngase nëse shkon aty duhet ta zbulosh avretin dhe të veprosh shumë harame/gjynahe. Përderisa kjo gjë sjell si pasojë veprimin e disa harameve, është e ndaluar. Njeriu duhet të jetë i kënaqur me atë që e jep Allahu. Çështja se gjithqysh duhet lindur djalë, është prej injorancës, nuk është prej Islamit. Nëse Allahu të ka dhuruar vajza, Ai ta ka hapur një derë të xhenetit. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: ***"Kush i rrit dhe i edukon në Islam***

tri vajza, do të hyjë në xhenet." E kanë pyetur: "*Edhe dy*?" ka thënë: "***Edhe dy***." Allahu thotë në Kuran: **"Ai i dhuron vajza kujt të dojë e djem kujt të dojë. Disave u dhuron të dyja gjinitë: djem e vajza; e, kë të dojë e lë pa fëmijë."** Shura 49-50. Andaj, njeriu duhet të jetë i kënaqur me Caktimin e Allahut. Pastaj ka mundësi që djali të cilin shumë e dëshiron, kur të rritet nuk të respekton, nuk të do, nuk sillet mirë. E nga ana tjetër vajza sillet mirë me ty. Qëllimi i myslimanit nuk është që gjithsesi të ketë djalë apo vajzë. Mirëpo, qëllimi i tij duhet të jetë që të ketë fëmijë të cilët e adhurojnë Allahun, duke i edukuar në këtë, e pas vdekjes së tij ata të luten për të. Kur prindi i edukon fëmijët e tij në Islam, qofshin djem apo vajza, dhe e vazhdojnë jetën me Islam, atëherë për çdo vepër të mirë që e veprojnë, i vije atij një pjesë e shpërblimit, edhe nëse është i vdekur.

9. A lejohet të themi "Filani ma ka ngjitur gripin" dhe a lejohet ta largojmë atë që është me grip apo t'i largohemi?

Nuk ka të keqe nëse largohesh prej atij që ka grip apo sëmundje ngjitëse (infektive). Porse, gripi kalon tek tjetri veçse me lejen e Allahut. Disa dijetarë kanë thënë: "*Nëse njeriu e ka besimin e madh dhe mbështetjen e fortë në Allahun, nuk ka të keqe të përzihet me njerëz të sëmurë*", siç ka ndodhur në disa raste me Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem dhe shokët e tij, të cilët e kanë ditur se asgjë nuk ndodhë pa kaderin e Allahut, "*por nëse e ka besimin e dobët dhe kur përzihet me të tjerët i ngjitet gripi apo ndonjë sëmundje tjetër, dhe kështu fillon të ketë mendim të keq*

për Allahun dhe kaderin e Tij duke thënë: "sikur mos të isha përzier me ta nuk do më ndodhte kjo gjë", atëherë i tilli më mirë është të largohet e të mos përzihet me ta". Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "**Nuk ka sëmundje ngjitëse**", qëllimi me këtë siç e kanë shpjeguar dijetarët është se njerëzit e injorancës kanë pasur mendimin se sëmundja vetvetiu kalon nga njëri person në tjetrin dhe ai salAllahu alejhi ue selem ka dashur ta largojë këtë besim të kotë, duke treguar se sëmundja kalon te tjetri veçse me lejen dhe kaderin e Allahut, e nuk ka mundësi të ngjitet vetvetiu. Nëse Allahu ka bërë kader, ajo të ngjitet e nëse jo, nuk të ngjitet. Dikur prej sëmundjes së malaries ka ndodhur të kenë vdekur e gjithë familja përveç njërit. Kjo tregon se sëmundja nuk kalon vetvetiu te tjetri, mirëpo kalon me kaderin dhe vullnetin e Tij. Nëse thua "filani ma ka ngjitur gripin" duke qenë i sigurt në këtë, nuk ka të keqe, sepse Allahu e ka bërë kader që ai të ta ngjisë ty gripin. Lejohet të thuash: "Nuk po shkoj te filan familja sepse janë me grip, se mos ma ngjisin atë!", duke e thënë me besim të shëndosh se kjo ndodhë me kaderin e Allahut. E nëse thotë me besim të kotë se sëmundja ngjitet vetë, kjo nuk lejohet.

10. Kur bëj mëkat më humbet dëshira për vepra të mira (istigfar e dhikër) nga mërzia, si më këshilloni?

Shejtani të ka ngadhënjyer dy herë: të parën herë kur ti ke bërë mëkat, të dytën herë kur ta ka humbur shpresën në Mëshirën e Allahut. Kur njeriu vepron mëkate dhe e humbet vullnetin, do të thotë e ka

humbur shpresën në Mëshirën e Allahut se Ai e fal. Prandaj njeriu duhet të kërkojë falje tek Allahu (të kthehet tek Ai) menjëherë pasi e bën një mëkat, duke u penduar dhe shpresuar shumë në pranimin e pendimit dhe në faljen e atij mëkati. Allahu është el Gafur (Falës i Madh), et Tewab (që i pranon shumë pendimet e njerëzve), këto janë prej Cilësive dhe Emrave të Tij. Nuk duhet pasur mendim të keq për Allahun se Ai nuk i fal mëkatet e nuk i pranon pendimet. Përkundrazi, duhet shpejtuar në pendim dhe shpresë ndaj Tij. E pastaj duhet shtuar veprat e mira pas mëkatimit, ngase veprat e mira i shlyejnë ato të këqija. Allahu thotë: **"...veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija."** Hud, 114. Andaj duhet shpejtuar në bërjen e një vepre të mirë që nuk e ke bërë më herët (p.sh.: falja e dy apo e katër rekateve nafile në kohë të lejuar duke shpresuar se kjo vepër e mirë e shlyen atë mëkat që e ke bërë). Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **"Veprën e keqe pasoje me një të mirë dhe ajo e shlyen atë."** Besimtari është mirë ta bëjë shprehi që në rast se i bën mëkat Allahut, pendimit dhe kërkim faljes tek Allahu t'ia bashkëngjitë edhe bërjen e një vepre të mirë. Ka ardhur në hadith se nëse njeriu ka bërë një mëkat dhe ka kërkuar falje tek Allahu, atëherë t'i falë dy rekate namaz vullnetar. Nëse merr abdes mirë sipas sunetit dhe i fal dy rekate, duke qenë sa më i përqendruar në namaz, Allahu ia fal atë mëkat. Duhet pasur kujdes ndaj intrigave të shejtanit ngase ai përmes shumë rrugëve mundohet që njeriun ta çojë drejt humbjes, t'ia asgjësojë veprat e mira, t'a pengojë nga adhurimet. Si

pasojë e cytjes së tij është se ti ke rënë në mëkat dhe mos lejo që përsëri të depërtojë tek ti duke ta humbur vullnetin dhe shpresën në Mëshirën e Allahut dhe duke mos bërë vepra të mira. Prandaj, dijetarët thonë se frika e lavdëruar me të cilën kënaqet Allahu është ajo që të nxitë në veprimin e veprave të mira. Në këtë rast, ti e ke kujtuar Allahun dhe Madhështinë e Tij pas mëkatimit, mirëpo e ke tepruar duke rënë në dëshpërim. Kjo nuk është frika që e do Allahu nga ti. Frika ndaj (dënimit të) Allahut është ajo frikë për shkak të cilës shton veprat e mira dhe pendimin; kjo është ajo frikë që Allahu e kërkon nga ti.

11. A është mëkat nëse gjatë dhikrit (pyetësi thotë: tespiheve) që bëhet pas namazit, të shtojmë më shumë sesa që ka ardhur në sunet?

Nuk thuhet tespih, por thuhet dhikër pas namazit (farz). E forma e dhikrit pas namazit ka ardhur në disa forma:
-33 herë subhanAllah, 33 elhamdulilah, 33 Allahu e ekber, duke e përmbyllur me të njëqindtën herë me fjalët "La ilahe il-lAll-llahu wahdehu la sherike leh, lehul mulku we lehul hamdu, we huwe ale kul-li shejin kadir";
-33 herë subhanAllah, 33 elhamdulilah, 34 Allahu ekber;
-10 herë subhanAllah, 10 elhamdulilah, 10 Allahu ekber;
-11 herë subhanAllah, 11 elhamdulilah, 11 Allahu ekber;

-25 herë subhanAllah, 25 elhamdulilah, 25 Allahu ekber, 25 La ilahe il-lAll-llahu wahdehu la sherike leh, lehul mulku we lehul hamdu, we huwe ale kul-li shejin kadir.
Cilëndo prej tyre që e vepron lejohet. Kjo është prej sunetit. Madje është mirë siç thotë Shejkh Uthejmin rahimehullah që personi të mos i përmbahet gjithmonë veç njërës formë prej këtyre dhikreve, por të kombinojë mes tyre, duke e zbatuar sunetin gjatë jetës së tij, ashtu siç është transmetuar. Për të gjitha këto dhikre shpërblimi është i njëjtë ashtu siç ka ardhur në hadith se "*...**fshihen mëkatet edhe nëse janë sa shkuma e detit***". E nuk thuhet: "Nuk po i them këto që janë më pak në numër (10 herë) sepse dhikri me 33 herë ka më shumë shpërblim", ngase shpërblimi është i njëjtë. Madje, nëse personi e bën dhikrin duke pasur si qëllim praktikimin e sunetit, ka shpërblim edhe më shumë. Duhet përmbajtur numrit që ka ardhur në sunet. Vetë fakti se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e ka caktuar numrin, këtu fshihet një sekret, e ai e di më së miri se pse e ka caktuar. Duhet munduar po ashtu që personi të mos habitet gjatë bërjes së dhikrit. Andaj, dhe duhet numëruar me gishta. Kur i bën me gishta nuk hutohesh. Nëse ndodh që të janë përzier, atëherë e le atë që është më e sigurta, p.sh.: nuk e di a i ke thënë 32 apo 34 herë, atëherë e le se i ke thënë 32 herë ngase kjo është më e sigurt dhe shton edhe një duke i bërë 33 herë.

12. Nëse personi thotë: "Jemi krijuar për t'u kënaqur" a bën kufër?

Nuk mund të themi se bën kufër. Porse atij duhet t'i sqarohet çështja se nuk është krijuar për t'u kënaqur, por për ta njësuar Allahun me adhurim dhe për ta njohur Atë. Ky është qëllimi i krijimit të tij. Nuk ka kënaqësi në këtë dunja. Njeriu mund të kënaqet për pak, e pas kësaj mund të pasojnë fatkeqësitë, sprovat e vështirësitë. Ai person për të cilin të tjerët pretendojnë se është duke u kënaqur, në realitet nuk është duke u kënaqur. Shembull: një milioner nuk ka kënaqësi edhe pse ka tërë këtë pasuri. Nuk ka kënaqësi sepse ai gjithmonë jeton me frikë se mos po e vjedhin, se mos po ia kidnapojnë ndonjë familjarë, se mos po e humbet pasurinë, se a po i ec mirë rritja e pasurisë. Njeriu nuk ka kënaqësi edhe pse ka pasuri. Kënaqësia është veç në adhurimin ndaj Allahut të Madhërishëm, në asgjë tjetër, aty kënaqet zemra. Nëse dikujt Allahu i ka dhënë pasuri dhe ai e vendos atë në zemrën e tij (lidhet pas saj), do të gjejë dëshpërim e jo kënaqësi. Dijetarët thonë: *"Selefi pasurinë e ka pasur në dorë, e jo në zemër."* Qëllimi se e kanë pasur në dorë do të thotë: e kanë konsideruar mjet përmes të cilit e kanë arritur kënaqësinë e Allahut. Edhe nëse e kanë humbur pasurinë nuk kanë ndjerë shumë dhimbje për këtë, ngase nuk e kanë pasur në zemër, por në duar. Sa e kanë pasur në duar e kanë shfrytëzuar, duke dhënë lëmoshë, duke u ndihmuar nevojtarëve dhe në vepra që e kënaqin Allahun, si: hapja e puseve, bunarëve, burimeve, në ndërtimin e xhamive etj. I tillë duhet të jetë besimtari.

13. Pas faljes së namazit të sabahut detyrohemi të flemë për shkak të lodhjes me fëmijët, a ka ndonjë të keqe?

Nuk është gjë e ndaluar të flihet pas sabahut, por nuk preferohet. Më së mirë është që njeriu, në bazë të mundësive, të qëndrojë zgjuar së paku derisa të lindë dielli. Pasi lind dielli, mund të flejë. Bereqeti është në kohën derisa të lindë dielli, ose afër lindjes së tij. Qëllimi i qëndrimit zgjuar është bërja dhikër Allahut (përmendja e Allahut). Kur njeriu rri zgjuar dhe e përmend Allahun, do të ketë bereqet në këtë kohë. Kjo gjë transmetohet prej sahabëve, siç tregojnë dijetarët. Edhe nëse kanë udhëtuar tërë natën duke qenë pa gjumë, ata pasi e kanë falur namazin e sabahut, nuk kanë fjetur derisa është afruar lindja e diellit, e gjatë kësaj kohe kanë bërë dhikër. Transmetohet se Abdullah ibn Mesudi radijAllahu anhu kur ka qenë në një rast me nxënësit e tij i ka pyetur: "*A lindi dielli*?", i kanë thënë: "*Jo, ende.*" Atëherë ka vazhduar me dhikër. Pastaj i ka pyetur përsëri: "*A lindi dielli*?", i kanë thënë "*Jo*". Dhe ka vazhduar përsëri me dhikër. Kur ka lindur dielli i kanë treguar dhe ai ka thënë: "*Lavdia i takon Allahut që na dha bereqet dhe na shpëtoi në ditën tonë!*" Ai ka llogaritur që nëse bëhet dhikër gjatë kësaj kohe derisa të lindë dielli, pjesa tjetër e ditës do të të shkojë mbarë, pra Allahu të ka shpëtuar brenda asaj dite. Andaj është mirë që në këtë kohë të mos flihet. Mirëpo, nëse dikush fle, nuk do të thotë se ka bërë haram, porse e ka humbur një mirësi të madhe.

14. Çfarë gjykimi ka fjala "farë e keqe", e "pjellë e keqe" që i thuhet tjetrit, edhe nëse është me ato tipare të këqija sikurse farefisi i vet?

Këto janë prej fjalëve të këqija të cilat myslimani duhet të largohet. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: ***"Besimtari nuk është fjalë ndyrë*** (duke i rënduar të tjerët me to), ***as nuk flet fjalë të ulëta dhe as nuk është mallkues."*** Këto nuk duhet të jetë cilësi të besimtarit. Nuk bën të flasë fjalë të tilla dhe të tjera të kësaj natyre. Selefi ka thënë: "*Nëse i thua tjetrit "o gomar" (*apo siç përdoret tek ne "lopë apo qurë etj"*), atëherë Allahu në Ditën e Gjykimit do të të marrë në llogari e do të thotë: "A e kam krijuar atë si gomar?"* Besimtarit nuk i lejohet të përdorë fjalë të tilla. Sidomos mes bashkëshortëve ndodh kjo, veçanërisht prej burrit ndaj gruas, gjë kjo prej së cilës duhet pasur kujdes. Kur atij nuk i pëlqen ndonjë gjë prej saj, e ofendon me fjalë të tilla. I Dërguari salAllahu alejhi ue selem ka ndaluar t'i fliten gruas fjalë rënduese. Pastaj duhet ditur se për çdo fjalë që e themi për të tjerët do të japim llogari tek Allahu. Në këtë botë ne flasim dhe Allahu na dëgjon çdo fjalë, e në Ditën e Gjykimit do të përgjigjemi për çdo fjalë të thënë ndaj të tjerëve, shembull: filani është i gjatë, i shkurt, i shëndoshë, i hollë, duke i thënë me qëllim të përgojimit ose të nënçmimit, apo se është farë e keqe apo pjellë e keqe siç ka ardhur në pyetje. Andaj, duhet pasur kujdes në ruajtjen e gjuhës sepse ajo që më së shumti njeriut ia shkatërron fenë dhe veprat është gjuha. I Dërguari salAllahu alejhi ue selem ka thënë: ***"Kush m'i garanton mua dy gjëra: atë që ka mes dy***

nofullave (gjuhën) dhe mes dy kofshëve (organin gjenital), ia garantoj xhenetin", kjo tregon se sa e rëndësishme është ruajtja e gjuhës ngase ai e ka krahasuar/përmendur së bashku me ruajtjen e nderit (duke mos bërë imoralitet), pra i ka futur në të njëjtin nivel.

15. Pse është mëkat të festohet ditëlindja?

Festimi i ditëlindjes është mëkat sepse në Islam janë veç dy festa. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem i ka caktuar ato. Ai thotë se Allahu, të gjitha festat ua ka zëvendësuar në dy festa, që janë: Fitër Bajrami dhe Kurban Bajrami. Çdo festë tjetër jashtë këtyre të dyjave është e ndaluar në Islam dhe është prej bidateve në fe. E festimi i ditëlindjes është prej bidateve të shpikura. Nuk lejohet të festohet ditëlindja. Gjithashtu, ajo është imitim i jobesimtarëve. Ajo që njihet nga historia e kësaj feste, është se atë e kanë festuar popujt idhujtar. Ka qenë gjithmonë traditë tek ta festimi i përvjetorëve të ngjarjeve, apo ditëlindjeve, apo i ditës së pranverës, verës, dimrit etj. Këto kanë ekzistuar gjithmonë te paganët, sidomos në Evropë. Andaj, nuk lejohet imitimi ndaj tyre. Pastaj, siç kanë thënë dijetarët: *"Si mundet që myslimani ta festojë ditëlindjen, kur një vit më shumë i është afruar vdekjes, duke lënë pas një vit të stërmbushur me mëkate, për të cilat nuk e di a ia ka falur Allahu apo jo?! Si ka mundësi që ai t'i gëzohet kësaj?!"* Përkundrazi, duhet të mërzitet. Përveç kësaj, gjatë festimit të ditëlindjeve ka të tjera mëkate, si: mendimi i një dëshire, fryrja e qirinjve për t'u plotësuar një dëshirë, që janë besime të kota.

Ndoshta dikush fillimisht nuk i vepron, mirëpo nëse hapet dera e festimit të ditëlindjes, atëherë të gjitha ato veprime/besime të kota që i bëjnë jobesimtarët të këtë raste, do të depërtojnë duke u vepruar. Andaj duhet të mbyllet dera e këtyre gjërave.

16. A është sevap të agjërohet çdoherë e hëna dhe e enjtja?

Kjo është prej sunetit dhe njeriu ka shpërblim të madh nëse e agjëron të hënën dhe të enjten vazhdimisht. Për të hënën i Dërguari salAllahu alejhi ue selem ka thënë: ***"E hëna është dita në të cilën kam lindur."*** Ajo është dhe dita në të cilën i ka zbritur shpallja. Andaj është mirë që kjo ditë të agjërohet. Kjo është mënyra se si pasuesit e sunetit e kremtojnë ditën e lindjes së të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem, këtë mirësi e dhunti prej Allahut, pra përmes agjërimit (me vepra të mira), e jo me bidate, me festim e kremtim duke bërë mevlude. Ata çdo të hëne e agjërojnë si falënderim Allahut që e ka krijuar Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem dhe që i ka zbritur shpallja, përmes së cilës jemi udhëzuar. Gjithashtu ka hadithe të tjera në të cilat tregohet se të hënën dhe të enjten i shfaqen Allahut veprat e robërve të Tij dhe Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem thotë: ***"Andaj dëshiroj që veprat e mia t'i shfaqen Allahut duke qenë unë agjërueshëm."***

17. A u lejohet femrave heqja e qimeve të fytyrës?

Në këtë ka mospajtime mes dijetarëve, mirëpo mendimi më i saktë është përveç vetullave, i lejohet femrës t'i heqë qimet e fytyrës, si: qimet mbi buzë. Nëse i heq qimet e kësaj pjese nuk vërehet se ka ndryshuar diçka, ngase origjina është që femra të mos ketë qime në atë pjesë. Ajo që i ndalohet është heqja e qimeve të vetullave. I Dërguari salAllahu alejhi ue selem ka thënë se nëse femra i heq vetullat, e ndryshon krijimin e Allahut. Kur e vepron këtë gjë, i ndryshon krejt pamja e saj, pra e ndryshon krijimin e Allahut. Dijetarët që e lejojnë heqjen e qimeve të fytyrës (përveç vetullave) thonë se nuk ka ndalesë për këtë gjë. Në kohën e të Dërguarit ka ekzistuar kjo gjë. Përderisa nuk ka ndalesë, gjërat mbeten të lejuara, siç është parim në Islam. Sa i përket qimeve të pjesës ndërmjet dy vetullave te gruaja, mendimi më i saktë është se lejohet të hiqen ngase nuk konsiderohen prej vetullave.

18. A lejohet t'i thërras Cilësitë e Allahut dhe të lutem me fjalët "o Allah, për hir të Pejgamberit..."?

Nuk lejohet thirrja e Cilësive të Allahut, duke thënë "O Fytyra e Allahut", apo "O Mëshira e Allahut, më mëshiro!", apo "O Falja e Allahut, më fal!" Njeriu duhet ta thërrasë Allahun gjatë lutjes së tij, kurse Cilësitë e Tij duhet t'i vë si ndërmjetës mes tij dhe Allahut duke thënë: "O Allah, me Mëshirën Tënde më mëshiro!" apo "me faljen Tënde me fal mua!" Pejgamberi salAllahu

alejhi ue selem është lutur: ***"O i Gjallë i Përhershëm, o Mbajtës i çdo gjëje, me Mëshirën Tënde kërkoj ndihmë!"*** Po ashtu, lejohet të lutesh përmes Emrave të Tij duke thënë: "O Falës i Madh (ja Gafur), më fal mua!" apo "O i Gjithëmëshirshëm (Ja Rrahman), më mëshiro mua", apo "O Furnizues (ja Rrezak), më furnizo!" Ky është ndërmjetësim i lejuar (përmes Emrave dhe Cilësive të Allahut). Formë tjetër e ndërmjetësimit të lejuar është kur bëhet përmes veprave të mira (të bëra për hir të Allahut), siç është ngjarja e tre personave të cilëve guri ua ka bllokuar hyrjen e shpellës (duke mbetur brenda). Ka prej formave të ndërmjetësimit që i veprojnë disa njerëz të cilat janë shirk i madh ose janë bidate. Bidat është kur bëhet ndërmjetësim përmes të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem, përmes Qabesë, përmes njerëzve të devotshëm/të mirë. Ata luten: "O Allah për hir të të Dërguarit, më fal!" apo "për hir të Qabesë", apo "për hir të Ramazanit". Kjo është rrugë që çon në shirk dhe nuk ka bazë. Kështu, njerëzit kanë filluar në këtë formë, pastaj dikur i janë lutur vetë të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem. Kjo formë nuk lejohet dhe është ndërmjetësim i ndaluar. Shirk është kur njeriu e lut krijesën, p.sh.: "O i Dërguar, ndërmjetëso për mua tek Allahu", kështu lutjen e tij ia drejton të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem dhe ia kushton një adhurim krijesës. Atëherë kjo është shirk i madh. I Dërguari salAllahu alejhi ue selem ka thënë: "***Lutja është vetë adhurimi***." Ndërsa e sakta është kur lutja bëhet në këtë

formë: *"O Allah, bëje të Dërguarin ndërmjetësim për mua!"*. Kjo lejohet sepse lutja po i drejtohet Allahut.

19. Kam shumë vesvese për çdo gjë, si t'i largoj ato?

Ai që është goditur me vesvese, është goditur me një sprovë shumë të madhe, ngase njeriu bën luftë me vetveten, duke e pasur një armik të brendshëm. Pa dyshim se ato janë prej shejtanit. Ajo që ndihmon më së shumti në largimin e tyre është të drejtuarit tek Allahu me lutje të sinqerta dhe mbështetje. Po ashtu, vesveset duhet të injorohen. Atyre duhet t'u pritet rruga qysh në fillim. Si të fillojnë të paraqiten duhet të injorohen. Nëse gjatë abdesit ke vesvese se nuk e ke larë mirë dorën, apo e ke lënë një pjesë të këmbës pa larë, duhet ta injorosh këtë vesvese duke mbetur në mendimin se e ke larë mirë. Kështu injorohen vesveset. E kur njeriu shikon se cila është ajo pjesë e pa larë, apo shikohet në pasqyrë a e ka larë mirë fytyrën, veçse ka filluar t'ua hapë derën vesveseve dhe ato shkojnë duke u shtuar. Ato nuk pakësohen kur njeriu i ushqen. Kur njeriu i injoron ato dhe përsëri i vijnë, pa dyshim se ka shpërblim, sepse kjo është sprovë, luftë me shejtanin. Prej abdesit kalojnë në namaz. Ka njerëz të cilët e kanë braktisur krejt namazin si pasojë e tyre. Shejtani i vjen njeriut nga aspekti i bërjes vesvese se Allahu nuk ta pranon abdesin apo namazin e bërë në këtë formë, se duhet të jetë më i përkryer. Por, është me rrezik çështja se Allahu mund të mos e pranojë atë abdes dhe namaz me vesvese, siç thotë ibn Kajjim, sepse vesveset janë bidat në fe. Ato nuk i ka bërë i Dërguari salAllahu alejhi

ue selem, as shokët e tij. Ata cilët nuk kanë tepruar në fenë e Allahut. Kështu, shejtani përveç që e ka ngarkuar njeriun me vesveseve, po ashtu ia ka rrezikuar edhe atë adhurim që e bën. E qëllim i shejtanit është t'ia prishë dhe shkatërrojë veprat njeriut. Sa herë që njeriu i bindet shejtanit në vesvese, ai përqeshet/tallet me të. Mirëpo, nëse gjendja e njeriut ka eskaluar dhe nuk mundet më t'i kontrollojë vesveset, dijetarët thonë se i tilli falet ashtu siç mundet, do të thotë edhe nëse i mbetet diçka mangët prej namazit ai vazhdon të falet dhe namazin e ka të saktë, derisa të kalojë kjo gjendje e rëndë.

20. A lejohet të bëj lutje pas çdo namazi?

Nuk është transmetuar nga i Dërguari salAllahu alejhi ue selem se pas çdo namazi të jetë lutur apo t'i ketë ngritur duart duke bërë lutje. Sikur të ishte e lejuar ai dhe shokët e tij do ta bënin. Janë transmetuar disa dhikre dhe lutje të cilat i Dërguari salAllahu alejhi ue selem i ka bërë pas namazit (farz) pa i ngritur duart. Kjo dhe lutje të tjera të transmetuara janë sunet të thuhen. Por, të bëhet traditë që pas çdo namazi të ngriten duart duke bërë lutje, kjo nuk është prej sunetit të të Dërguarit salAllahu alejhi ue selem. Disa dijetarë e ndalojnë këtë rreptësisht dhe thonë: *"I thua vetëm ato dhikre e lutje që kanë ardhur në sunet, jo të tjera."* E disa dijetarë e lejojnë të bëhet lutje nganjëherë, p.sh.: kur personi e fal namazin dhe ka nevojë ta lusë Allahun për diçka, atëherë për shkak të kësaj nevoje i ngrit duart dhe e lut Allahun pas namazit. Por, jo të bëhet kjo gjë traditë që gjithmonë ta lutësh Allahun pas namazit.